

AMNESTY INTERNATIONAL PUBLIC STATEMENT

28 qershor 2021 EUR 73/4350/2021

KOSOVË: T'U JEPET FUND PADIVE STRATEGJIKE KUNDËR PJESËMARRJES PUBLIKE QË SYNOJNË TË HESHTIN AKTIVISTËT E MJEDISIT

Kelkos Energy duhet të tërheqë paditë për shpifje të ngritura kundër aktivistëve të mjedisit në Kosovë* të cilat duket se janë hartuar t'a pengojnë punën e tyre, t'i trembin dhe t'i heshtin ata, u shpreh sot Amnesty International. Meqë pretendimet e pambështetura dhe joproporcionale për dëme janë kthyer në pengesë të qartë për punën e mbrojtësve të drejtave të njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile, autoritetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar një ambient të sigurt dhe fuqizues në të cilin ata mund të ushtrojnë rolet e tyre pa u trembur se mund të përballen me hakmarrje.

Kelkos Energy, një kompani e madhe menaxhimi hidrocentralesh me bazë në Austri dhe me veprimtari në Kosovë¹ ka përdorur paditë për shpifje dhe ka kërcënuar me padi të tilla në shënjestër të së cilave janë aktivistët që ngrejnë zërin kundër ndikimit mjedisor të hidrocentraleve që operojnë në zona të mbrojtura të vendit si dhe mungesës së kontrolleve të duhura nga autoritetet e Kosovës gjatë procesit të licensimit të këtyre hidrocentraleve.

Më 1 qershor 2020, Kelkos Energy ngriti një padi për shpifje kundër znj. Shpresa Loshaj, një aktiviste mjedisi dhe themeluese e organizatës jo-qeveritare Pishtarët. Në padi, Kelkos Energy kërkoi dëmshpërblim prej EUR 100,000 nga znj. Loshaj për dëmin e shkaktuar me fushatën e saj publike kundër veprimtarisë së Kelkos Energy në rajonin e Deçanit, ku kompania menaxhon katër hidrocentrale. Kelkos Energy ka kërkuar në padi që znj. Loshaj të tërheqë deklaratën e saj publike, të kërkojë falje publikisht dhe në të ardhmen të shmangë deklaratat rreth kompanisë me "fakte të pavërteta"². Në një padi të ngjashme në janar të 2020-ës, Kelkos Energy ka kërkuar dëmshpërblim prej EUR 100,000 për dëmtim imazhi të shkaktuar nga Adriatik Gacaferi, një aktivist mjedisi nga Deçani, për një postim në Facebook në të cilin autori kritikonte hidrocentralet e kompanisë në rajonin e Deçanit.³ Kelkos Energy ka kërkuar që z. Gacaferi të fshijë postimin e kontestuar dhe të publikojë një deklaratë me të cilën tërhiqet nga deklaratimet e mëparshme. Të dy proceset gjyqësore janë ende në pritje.

Amnesty international ka bashkëpunuar ngusht me avokaten që përfaqëson dy aktivistët⁴ dhe cilëson paditë e depozituara në Kosovë kundër znj. Loshaj dhe z. Gacaferi si Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Paditë e tilla janë të natyrës së pa meritë dhe synojnë që të trembin dhe të heshtin zërat kritik ndaj çështjeve me interes publik. Paditë SLAPP janë gjithnjë e më shumë duke u kthyer në një pengesë kundër

* Amnesty International përdorë një asterisk në fund të emrit "Kosovë" si një përcaktim me pajtueshmëri të gjërë ndërkombëtare. Ky përcaktim është rezultat i marrëveshjes së 2012-ës për të lejuar Kosovën* që të përfaqësojë institucionet e veta pa autoritetin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në forume rajonale. Marrëveshja e negociuar nga BE-ja mbi Përfaqësimin Rajonal dhe Bashkëpunimin shprehet se Kosova* duhet të referencohet në takime rajonale dhe në marrëveshje rajonale me një asterisk dhe një fusnotë që lexon "Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicionit të statusit, dhe është në linjë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së Kombëve të Bashkuara dhe Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë".

¹ Kelkos Energy është filial i Kelag-Kärntner Elektrizitäts. Kelkos Energy zotëron katër hidrocentrale në perëndim të Kosovës: Lumbardhi 1 (8 MW), Lumbardhi 2 (7 MW), Belaja (7.5 MW) dhe Deçani (9.5 MW).

² Padia e Kelkos Energy Sh.P.K për shpërblim dëmi kundër cenimit të imazhit për shifje kundër znj. Shpresa Loshaj, 27 maj 2020, e disponueshme për Amnesty International.

³ Padia e Kelkos Energy Sh.P.K për shpërblim dëmi kundër cenimit të imazhit për shifje kundër z. Adriatik Gacaferi, 31 janar 2020, e disponueshme për Amnesty International.

⁴ Amnesty International ka bashkëpunuar ngushtë me avokaten që përfaqëson znj. Loshaj dhe z. Gacaferi në lëndët e tyre. Përveçse përfaqëson aktivistët, avokatja është njëkohësisht shërben si *Fellow* në ekipin e Amnesty International për Gjininë, Seksualitetin dhe Identitetin. Ky është një pozicion i përkohshëm dhe i papaguar nga Amnesty International. Kërkimi i kryer për këtë deklaratë publike dhe gjetjet e tij janë përgjegjësi vetme e ekpiti të Zyrës Rajonale Evropiane, e cila mbulon Ballkanin.

mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe gazetarëve që ekspozojnë të pushtetshmit, në veçanti korporatat, ndërsa kufizojnë padrejtësisht të drejtën e lirisë së shprehjes dhe shkruajnë publikun nga ekspozimi i sjelljes së paligjshme të autoriteteve dhe korporatave.

Amensty International ka kërkuar dhe ka marrë përgjigje zyrtare nga Kelkos Energy lidhur me gjetjet e përfshira në këtë dokument. Pjesë të deklaratës së kompanisë janë riprodhuar dhe referuar në tekst. Deklarata e plotë e Kelkos Energy është riprodhuar dhe aneksuar në këtë deklaratë publike.

PROCESI GJYQËSOR NDAJ SHPRESA LOSHAJ DHE HIDROCENTRALET NË DEÇAN

Për vite me radhë, znj. Loshaj ka qenë një kritike e zëshme e shfrytëzimit në rritje, me sa duket të pakontrolluar, të burimeve ujore të Kosovës për prodhimin e energjisë elektrike. Ajo ka përdorur rrjetet sociale dhe është shfaqur në media për të ngritur shqetësimet e saj mbi ndikimin mjedisor të hidrocentraleve që operojnë në rajonin e Deçanit, një park kombëtar i mbrojtur në Kosovën perëndimore, i vendosur përgjatë vargmalit të Bjeshkëve të Nemuna, kufirit natyral mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Pasi personalisht ka parë gërmimet e mëdha në këtë zonë, rreshqitjet e vazhdueshme të dheut dhe tharjes së shtratit të lumit ku përpara kishte ujë të bollshëm, znj. Loshaj ka filluar të ngrejë pyetje lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së Kelkos Energy në luginë për të prodhuar energji elektrike. Angazhimi i saj publik mbi këtë çështje dhe kërkesat e saj për më shumë transparencë në procesin e licensimit si dhe rritjen e mbikqyrjes mbi veprimtarinë e kompanive energjetike ka çuar në ngritjen e padisë për shpifje nga Kelkos Energy.

“Kur kam shkuar në luginën e Deçanit në 2018-ën, pas largimit nga Kosova për shumë vite, u habita sa shumë kishte ndryshuar. Në vend të lumenjëve me ujë të pastër dhe kullosave që mbaj mend nga fëmijëria, u përballa me shkatërrime të mëdha. Banorët ishin të pakënaqur. Sidoqoftë, askush nuk ishte i gatshëm të ngriste zërin. Kjo më bëri edhe më të vendosur që të ngrija zërin për hidrocentralet pasi dikush duhej ta bënte. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me lumejtë. Ka të bëjë edhe me institucionet – të cilat dështuan në mbrojtjen e mjedisit, dështuan të konsultohen me komunitetet dhe dështuan në zbatimin e ligjit” – Shpresa Loshaj, aktiviste mjedisore.

Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me komunitetin

Në maj 2020, znj. Loshaj u ka shkruar autoriteteve të Kosovës për të pyetur si ishte e mundur që Kelkos Energy ka arritur të marrë një licensë të përkohshme veprimtarie nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) pa marrë përpara një leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Ministria e Mjedisit), siç edhe kërkohet me ligj.⁵ Ajo ka hedhur dyshime publike mbi zhvillimin e procesit dhe ka ngritur shqetësime të mëtejshme lidhur me përkushtimin e qeverisë për tu siguruar licensimin, operimin dhe mbikqyrjen e duhur të hidrocentraleve. Bazuar në analiza të pavarura ligjore⁶ mbi procesin e licensimit të lidhur me dy kompani, përfshirë edhe Kelkos Energy, znj. Loshaj ka argumentuar se kompanitë në Kosovë kanë operuar me të ashtuquajturat “licensa fiktive”.

Megjithëse ZRRE në Kosovë ka lëshuar një licensë të përkohshme për Kelkos Energy në 2019-ën, Kelkos Energy nuk kishte marrë lejen e duhur mjedisore deri në nëntor të vitit 2020.⁷ Znj. Loshaj ka ngritur pyetje lidhur me ligjshmërinë e

⁵ Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton se objektet e ndërtimit, instalimet dhe makineritë që i janë nënshtruar Vlerësimit të Ndikimit Mjedor nuk mund të fillojnë veprimtarinë e tyre pa një leje mjedisore, e cila duhet të merret brenda gjashtë muajve, gjatë së cilës kryhen procedurat e aplikimit dhe testimit për miratim teknik. Shih nenin 31 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025.

Zëvendës Ministria e Mjedisit ka konfirmuar për Amnesty International se hidrocentralet duhet që të marrin një leje mjedisore dhe një leje ujore për të filluar veprimtarinë. Intervistë (on-line) e Amnesty International me Zëvendës Ministren e Mjedisit, 22 qershor 2021.

⁶ Znj. Loshaj ka kërkuar nga Departamenti Ligjor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN) për një vlerësim ligjor të Rregullorës së Kosovës për Licensimin e Veprimtarive të Energjisë Elektrike, e cila konfirmoi që një kompani duhet të marrë së pari një leje mjedisore për tu licensuar dhe për të operuar. Korrespondenca e znj. Loshaj me BIRN është e disponueshme për Amnesty International.

⁷ Në nëntor 2020, Ministria e Mjedisit miratoi lejën mjedisore për hidrocentralin e Belajes dhe Deçanit por jo për Lumbardhin II, sikurse vihet re në reagimin me shkrim të Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International më 21 qershor 2021. Shih gjithashtu Prishtina Insight, “Dy hidrocentraleve të Kelkos u jepet license 40-vjecare” 12 nëntor 2020.

<https://prishtinainsight.com/two-kelkos-hydropower-plants-granted-40-year-licence/>. Në kohën e depozitimit të padisë kundër znj. Loshaj në qershor 2020, Kelkos nuk kishte leje mjedisore. Në korrik, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë konfirmoi për Der Standard që lejet mjedisore nuk ishin lëshuar për Kelkos në kohën e shkrimit, por vuri në dukje se Kelkos ka marrë “leje të përkohshme për ushtrim veprimtarie” për hidrocentralet e saj. Drejtori i Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Mjedisit tha për Der Standard se nuk është kryer vlerësimi i ndikimit mjedor. Shih Der Standard, “Flusssterben im Kosovo: NGOs

procesit, pasi edhe për licensat e përkohshme kërkohet që kompania aplikuese të përmbushë të gjitha kërkesat, përfshi edhe marrjen e një leje mjedisore.⁸ Për më tepër, kompania ka operuar së paku dy prej hidrocentraleve të saj pa lejet e duhura.⁹ Kelkos Energy e ka hedhur poshtë këtë pretendim duke deklaruar që hidrocentralet e saj nuk kanë operuar asnjëherë pa miratimin shprehimor të ZRRE-s.¹⁰ Megjithatë, në raportin vjetor të 2019-ës, ZRRE ka konstatuar se Kelkos Energy ka ushtruar veprimtarinë e saj tregtare në Deçan dhe Belaje që nga 2016-ta pavarësisht se nuk ka marrë licensë për prodhimin e energjisë dhe leje mjedisore.¹¹ Raporti i ZRRE-s shprehet që “kjo ndërmarje [Kelkos Energy] nuk është pajisur ende me licensë për prodhimin e energjisë elektrike për asnjërin prej tre (3) hidrocentralet si pasojë e mos nxjerrjes dhe dorëzimit në Rregullator të Lejes Mjedisore, e cila lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor të Kosovës”.¹²

Kelkos Energy ka pranuar që “pas ndërtimit procesi i lejëmarrjes së Lejes Mjedisore ka zgjatur më shumë se 4 vite (pavarësisht se ligji përcakton përiudhen maksimale prej 6 muajsh për procesin e lejes)” por kjo ka qënë për shkak të projektit të hidrocentralit i cili “ka qënë projekti i parë me kompleksitet të tillë” dhe vonesat nga Ministria e Mjedisit, e cila është kritikuar po ashtu edhe nga ZRRE për “shkelje të vazhdueshme të afateve” për lejet.¹³

Znj. Loshaj ka ngritur pikëpyetje mbi ligjshmërinë e vendimeve pa u siguruar fillimisht përmbushja e kriterëve, përfshi edhe lejet mjedisore.¹⁴ Ndërsa ligjet mbi mbrojtjen mjedisore të cilat rregullojnë procedurat e licensimit të veprimtarisë në fushën e energjisë¹⁵ kërkojnë që procesi i marrjes së licensës për ushtrimin e veprimtarisë duhet të jetë rigoroz dhe transparent, në praktikë autoritetet duke u nisur nga komuna deri në ministrinë përkatëse shpesh kanë negociuar kontrata ose i kanë dhënë leje kompanive të energjisë pa siguruar së pari studime të ndikimit mjedisor dhe pa mbajtur konsultimet e nevojshme me komunitetet vendore.¹⁶

Mungesa e shqyrtimit të kujdesshëm mjedisor nuk përbën parregullsinë e vetme në procesin e licensimit. Komuniteteve të prekura nga kjo praktikë në Deçan dhe zonat e tjera si Komuna e Shtërpcës, ju është penguar qasja në informata dhe janë përjashtuar nga vendimmarrja lidhur me aktivitetet e hidrocentraleve që operojnë në zonat ku ata banojnë. Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit¹⁷ dhe Ligji për Ujërat e Kosovës¹⁸ përcaktojnë se autoritetet janë përgjegjëse për të siguruar pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrje që lidhen me mjedisin, përfshirë menaxhimin e ujërave, duke marrë në konsideratë interesat e të gjithë palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes që ndikon në burimet ujore. Të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente publike dhe për të ndikuar mbi vendimet që lidhen me mjedisin në të cilin jetojnë janë të garantuara në Kushtetutën e Kosovës.¹⁹

Sidoqoftë, znj. Loshaj ka argumentuar që ZRRE ka dështuar t'i publikojë aplikimet për licensë të Kelkos Energy dhe të kërkojë reagimin nga komunitetet e ndikuara.²⁰ Institucioni i Avokatit të Popullit ka vënë në dukje në prill të vitit 2021 që autoritetet e çdo niveli, përfshi edhe Ministrinë e Mjedisit dhe autoritetet e Komunës së Deçanit, kanë mohuar aktivisht qasjen në informata dhe dokumente përkatëse që lidhen me veprimtarinë e hidrocentraleve, organizatave të shoqërisë dhe komunitetit vendor dhe kanë dështuar të përmbushin kërkesën e Avokatit të Popullit për informacion mbi procesin e

wehren sich gegen Kelag-Tochter, “7 July 2020, <https://www.derstandard.at/story/2000118556793/kelag-tochter-klagt-kosovarische-ngo><https://www.derstandard.at/story/2000118556793/kelag-tochter-klagt-kosovarische-ngo>

⁸ Ligji për Mjedisin, Neni 31, Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregulli ZRRE/Nr.07/2017, Nenet. 5, par.6 & 9, par. 1.3.

⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Raporti Vjetor 2018, mars 2019.

¹⁰ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 3.

¹¹ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Raporti Vjetor 2018, mars 2019.

¹² Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Raporti Vjetor 2018, mars 2019.

¹³ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 4.

¹⁴ Letër nga Shpresa Loshaj për Ministrinë e Mjedisit të Kosovës Lumir Abdixhiku, 06 Maj, 2020. E qasshme për Amnesty International.

¹⁵ Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit no.03/L-25. Neni 2 & 6; Ligji i Kosovës për Ujërat, no.04/L-147, Neni 84. Ligji i Kosovës për Rregullimin e Energjisë. Neni 28. Para. 3. Rregull i Zyrës së Rregullimit të Energjisë për Licensimin e Veprimtarisë së Energjisë Elektrike në Kosovë, 31.03.2017, Neni 6.

¹⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjen në informata, 03 shkurt 2021.

¹⁷ Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, nr. 03/L-025, Neni. 57.

¹⁸ Ligji i Kosovës për Ujin Nr. 04/L-147, Nenet. 3 & 6.

¹⁹ Kushtetuta e Kosovës, Nenet. 41 & 52 (2).

²⁰ Lajme të Gjelbra nga Ballkani, “Pronari i hidrocentralit të vogël padit aktivistën Shpresa Loshaj në Kosovë* për shpifje,” 22 shkurt 2021, <https://balkangreenenergynews.com/small-hydropower-plant-owner-sues-activist-shpresa-loshaj-in-kosovo-for-defamation/>

licensimit, gjatë hetimit të çështjes.²¹ Kelkos Energy ka thënë për Amnesty International që kompania ka organizuar një konsultim publik konsultimi me komunitetin në fillim të projektit në 2011-ën.²² Në shkurt të 2021-it, muaj pas ngritjes së padive kundër znj. Loshaj dhe z. Gacaferi, Kelkos Energy ka publikuar vullnetarisht dokumentacion dhe studime eksepertize mbi hidrocentralet për të “kapërcyer deficitin e mundshëm të transparencës...të cilin znj. Loshaj e ka kritikuar vazhdimisht.²³ Megjithatë, është me rëndësi të vihet në dukje se Kelkos Energy i ka publikuar dokumentet pas depozitimit të padisë kundër znj. Loshaj.

Në bisedë me Amnesty International, Ministria e Mjedisit ka konfirmuar që – deri tani – nuk ka qenë e mundur për publikun që të kërkojë dhe të marrë dokumente që lidhen me hidrocentralet nga Ministria.²⁴ Megjithatë, Ministria planifikon që të fillojë një nismë të re e cila do të mundësonte një sistem për gjurmimin publik të procesit të lejeve dhe qasjes në dokumente përkatëse dhe procedura, për të rritur transparencën e procesit.²⁵ Pothuajse nuk ka dyshim që fushata publike e znj. Loshaj, z. Gacaferi dhe organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e ka rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi procesin e licensimit dhe ka nxitur Kelkos Energy dhe Ministrinë e re të Mjedisit që të angazhohen në mënyrë më kuptimplotë me qytetarët dhe t'u mundësojë qasjen në dokumentet të rëndësishme mbi çështje me interes publik.²⁶

Në 2019, kohë kur u rritën edhe shqetësimet mbi procedurat e shkujdesura dhe pasojat potencialisht të pariparueshme mjedisore, Institucioni i Avokatit të Popullit nxiti Ministrinë e Mjedisit të pezullonte përkohësisht veprimtarinë e hidrocentraleve në Deçan dhe Shtërpce, por Ministria nuk iu bind masave të përkohshme.²⁷ Hetimi i mëtejshëm i procedurave të licensimit dhe të veprimtarisë së hidrocentraleve në Kosovë nga Avokati i Popullit zbuloi “mangësi në procesin operues” dhe “paqartësi lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së hidrocentraleve si rezultat i mungesës së transparencës dhe llogaridhënies nga organet kompetente”.²⁸ Raporti i Avokatit të Popullit, i publikuar në shkurt 2021, nxorri përfundimin se procedurat kontraktuale dhe procesi me anë të së cilit janë lëshuar licensat, shpesh nuk arrijnë të sigurojnë të drejtat e komunitetit për qasje në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimarrje dhe qasjen në drejtësi.²⁹ Në raport citohet veçanërisht mungesa e transparencës nga ana e autoriteteve përgjegjëse dhe paqartësia gjerësisht e përhapur mbi procedurat për organizimin e konsultimeve publike dhe sigurimin e pjesëmarrjes së publikut në to.³⁰

Në shtator të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës hapi një hetim zyrtar mbi licensimin, veprimtarinë, mbikqyrjen dhe procesin e aplikimit për marrjen e licenses për ndërtimin e hidrocentraleve.³¹ Në atë kohë, ish Ministri i Ekonomisë dhe Mjedisit z. Blerim Kuçi u shpreh se shqetësimet e aktivistëve mjedisorë dhe komuniteteve të ndikuara janë “legjitime” dhe pranoi se mund të ketë patur parregullsi ndërsa qeveria “ishte nën presion për të lëshuar leje për të përmbushur zotimet e saj për

²¹ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjen në informata, 03 shkurt 2021.

²² Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 5

²³ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 4.

²⁴ Intervistë (on-line) e Amnesty International me Zv. Ministrin e Mjedisit, 22 qershor 2021.

²⁵ Intervistë (on-line) e Amnesty International me Zv. Ministrin e Mjedisit, 22 qershor 2021.

²⁶ Ndikimi i znj. Loshaj dhe z. Gacaferi është pohuar nga Kelkos Energy në përgjigjen e dhënë për Amnesty International, por edhe nga të gjithë bashkëbiseduesit e institucioneve publike.

²⁷ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjen në informata, 03 shkurt 2021.

²⁸ Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit, <https://www.oik-rks.org/en/2021/02/03/report-with-recommendations-ex-officio-3652018-against-ministry-of-economy-and-environment-regarding-the-issue-of-lawfulness-of-the-procedures-concerning-the-hydropower-plants-in-the-country-as-we/>

²⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjen në informata, 03 shkurt 2021.

³⁰ Shih gjithashtu Konsorciumin e Shoqërisë Civile të Kosovës për Zhvillimin e Qëndrueshëm (KOSID), “Shkeljet ligjore që po thajnë lumenjtë”, nëntor 2020, <https://www.kosid.eu.com/wp-content/uploads/2020/12/Legal-violations-running-rivers-dry-KOSID-.pdf?fbclid=IwAR2qQyVXs8iss2jstXzEDnL3k-zaJGa2yrQyggmT5wmYg704WFitnrTVB4>

³¹ Lajme të Energjisë së Gjellbër nga Ballkani, “Deputetët e Kosovës shqyrtojnë lejet për hidrocentralet e vogëla,” 29 shtator 2020, <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-parliamentarians-reviewing-small-hydropower-permits/>

të rritur deri në 30% nivelin e energjisë së ripërtëritshme”.³² Komisioni Parlamentar që mbikqyr hetimin ka mbajtur disa dëgjesa gjatë vitit por rezultatet e hetimit nuk ishin të disponueshme në kohën e shkrimit të këtij materiali.³³

Në dhjetor të vitit 2020, OJQ-ja Pishtarët dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka ngritur një padi kundër Ministrisë së Mjedisit dhe ZRRE-s në të cilën kërkuan që lejet mjedisore dhe licencat për operim të lëshuara për Kelkos në nëntorin e vitit 2020 për dy hidrocentrale (atë të Deçanit dhe Belajes) të anulohen si pasojë e parregullsive në procedurat e licensimit.

Ndërsa gjykata nuk ka vendosuar ende meritat e kësaj çështjeje, në dy vendime procedurale të lidhura, në dhjetor të vitit 2020 dhe sërish në shkurt të vitit 2021, Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi që të pezullojë përkohësisht procedurat për lëshimin e licensave dhe lejeve mjedisore deri në një vendim përfundimtar mbi çështjen e sipërpërmendur si pasojë e rrezikut për “dëm mundësisht të pariperueshëm ndaj mjedisit”.^{34,35} Megjithatë, në prill të vitit 2021, Gjykata e Apelit anuloi vendimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore, duke lejuar Kelkos Energy që të vazhdojë veprimtarinë e saj deri në një vendim përfundimtar të gjykatës mbi çështjen fillestare nga dhjetori i vitit 2020.³⁶ Pishtarët dhe GLPS paraqitën me 23 qershor 2021 një kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nga Gjykata Supreme kundër vendimit të muajit prill nga Gjykata e Apelit.

Në prill të vitit 2021, Ministri i Mjedisit njoftoi për planet për të ngritur një grupe punues që do të rishikojë procedurat administrative për lëshimin e licensave të hidrocentraleve.³⁷ Së fundmi, me 25 maj 2021, një komision disiplinor nga Ministria e Mjedisit shkarkoi drejtorin në detyrë të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, z. Gani Berisha, për shkelje në procesin e licensimit të hidrocentraleve, përfshi edhe lejet ujore të lëshuara Kelkos Energy për tre prej hidrocentraleve të saj në Deçan – Lumbardhi II, Belaja dhe Deçani.³⁸ Raporti i Grupit të Punës dhe gjetjet përkatëse pritet të publikohen në fund të qershorit.

Pavarsisht pohimit nga zyrtarët e qeverisë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit se janë bërë gabime në procesin zyrtar për lëshimin e licensave – gjë që mbështet shqetësimet e ngritura nga znj. Loshaj dhe aktivistët e tjerë të mjedisit – Kelkos Energy duket e vendosur që të vazhdojë me paditë për shpifje. Kelkos Energy u shpreh për Amnesty International se kompania “ka bërë përpjekje për ndërmjetësim” me znj. Loshaj dhe z. Gacaferi dhe do preferonte që ta zgjidhte mosmarrëveshjen.³⁹ Ndërsa Kelkos Energy nuk ka specifikuar kushtet për një zgjidhje të tillë, ata u shprehën që, për shëmbull, nëse z. Gacaferi është “i përgaditur të tërheqë deklaratat e tij të pavërteta, Kelkos Energy do t’i tërhiqte pretendimet e pazgjidhura ndaj tij”.⁴⁰ Znj. Loshaj mohoi që të jetë kontaktuar drejtëpërdrejtë nga Kelkos Energy lidhur me çështjen por ka theksuar se tërheqja e deklaratave të saj do të ishte e papranueshme.

Procedurat gjyqësore në vazhdim kundër znj. Loshaj dhe z. Gacaferi kanë zhvendosur energjinë dhe burimet e tyre kundrejt vetëmbrojtjes në gjykatë, gjë që mund të ketë pasoja shkatërruese mbi të drejtat e tyre të njeriut dhe punën mjedisore. Akuzat, në dukje të pambështetura dhe dëmet e tepruara për të cilat Kelkos Energy kërkon shpërbtim mund të pengojnë fuqinë e reagimit qytetar për ndërgjegjësimin mbi çështje me interes publik dhe për tu kërkuar llogari qeverive dhe korporatave. Përpjekjet për të heshtur zërat kritik nepërmjet keqpërdorimit të sistemit të drejtësisë jo vetëm që

³² Kallxo, “Ministri i Mjedisit ndihet i tupëruar nga degradimi i lumit në Deçan,” 22 shtator 2020, <https://kallxo.com/lajm/ministri-i-mjedisit-ndihet-i-turperuar-nga-degradimi-i-lumit-ne-decan/>

³³ Shumica parlamentare ka ndryshuar pas zgjedhjeve të parakohshme në shkurt 2021, gjë që ka çuar në shtyrjen e përfundimit dhe publikimit të hetimit. Një deputete e Kuvendit të Kosovës, Fitore Pacolli u shpreh për Amnesty International se parlamenti i ri do të vazhdojë aktivitetet e filluara nga hetimi. Intervistë e Amnesty International me Kryetarën e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë, 22 qershor 2021.

³⁴ Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, Vendimi A nr. 2081/2020, 08 dhjetor 2021

³⁵ Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, Vendimi A nr. 2081/2020, 11 shkurt 2021.

³⁶ Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, Vendimi A nr. 2081/2020, 11 shkurt 2021.

³⁷ Ministri i Ri i Mjedisit, Liburn Aliu, njoftoi në prill 2021 se qeveria do të rinovojë të gjitha lejet e lëshuara për hidrocentralet. Shih: Kallxo, “Ministri Aliu paralajmëron shqyrtim të lejeve të hidrocentraleve,” 24 April 2021, <https://kallxo.com/lajm/ministri-aliu-paralajmëron-shqyrtim-te-lejeve-te-hidrocentraleve//>

³⁸ Koha, «Shkrakohet drejtori i ARLP-së për shkelje në licensim të hc-ve», 25 maj 2021, https://www.koha.net/arberi/272584/shkarkohet-drejtori-i-arpl-se-per-shkelje-ne-licencim-te-hc-ve/?fbclid=IwAR1MARGVil4cwUX4kSfdnQhXabz__AzWw7mnIFQhSHEh-R85rtz2RPVzpFk

³⁹ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 4.

⁴⁰ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 15.

minojnë të drejtat për lirinë e shprehjes dhe qasjes në informata por mund të kenë edhe një ndikim jashtëzakonisht të dëmshëm mbi organizatat e shoqërisë civile dhe mbikqyrësit e tjerë publik.

Dëmtimi i mjedisit

Sikurse vendet e tjera në rajon, Kosova ka përqaftuar në mënyrë entuziaste ndërtimin e hidrocentraleve të vogla. Si një vend që aspirojnë BE-në, Kosova ka patur një nxitje të konsiderueshme për t'iu bashkuar përpjekjeve të BE-së për energji të ripërtëritshme për të zëvendësuar pikat energjitike me bazë djegien e qymyrit dhe ka patur shumë përfitime nga kreditimi i dhënë për projekte për energji të ripërtëritshme të mundësuar nga institucionet financiare Evropiane dhe bankat tregtare.⁴¹

Përkushtimi i qeverisë për të rritur energjinë e ripërtëritshme dhe interesat e forta tregtare, të kombinuara me institucione të dobëta dhe korrupsion të gjithëpërfshirë,⁴² rezultoi në rregullore të zbatuara keq dhe çoi në përhapjen e shpejtë të hidrocentraleve në një proces në të cilin prioritet ju dha përfitimeve mbi mjedisin. Përgjatë viteve, me dhjetra hidrocentrale u ndërtuan në lumenjtë dhe përrojet me derdhje të shpejtë nga malet. Si rezultat, kantierët e ndërtimit dhe rrugët e përkohshme të ndërtuara për transportin e materialeve e kanë prishur anën e malit, ndërsa tubat dhe turbinat e mëdha kanë varfëruar gradualisht burimet ujore të përdorura nga fermerët për të ujitur fushat e tyre ndër breza.

Znj. Loshaj, z. Gacaferri dhe aktivistët e tjerë të mjedisit në Kosovë kanë folur shpesh në publik mbi degradimin e mjedisit të shkaktuar nga hidrocentralet. Znj. Loshaj ka argumentuar që hidrocentralet, të cilat përdorin metodën e sifonit për të marrë ujin nga lumenjtë për të gjeneruar energji elektrike, kanë shkaktuar mungesa të ndjeshme uji në fshatrat e rajonit dhe kanë patur një ndikim të madh negativ mbi ekologjinë e lumenjëve. Me të vërtetë, edhe Agjencioni për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka raportuar mbi dëmtimin e mjedisit nga përhapja e hidrocentraleve, përfshi edhe në zonën e Deçanit ku Kelkos Energy ushtron veprimtarinë e saj. AMMK arriti në përfundimin se shtrati i lumit pranë burimit të Lumbardhit është degraduar aq shumë nga hidrocentralet sa që jeta bimore përreth, e cila varet te uji dhe lagështira që ofron lumi, është praktikisht e shkatërruar.⁴³ AMMK, aktivistët e mjedisit dhe organizatat e shoqërisë civile⁴⁴, bashkë me komunitetet që jetojnë në zonat e ndikuara, kanë vërejtur rënien e theksuar në vëllimit të ujit gjë që ndikon direkt mbi speciet e kafshëve ujore, ndryshimin e lagështirës në ajër dhe mikroklimën e krijuar e cila rrezikon pyjet përreth dhe rrezikon në rritje nga rrëshqitjet e dheut.⁴⁵ Kelkos Energy i ka hedhur poshtë këto gjetje në një letër drejtuar Amnesty International, duke shtuar se kompania ka kryer investime madhore në rehabilitimin e lumit të Lumbardhit që nga fillimi i ndërtimit.⁴⁶ Kompania ka cituar edhe një letër të dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nga Njësia e Krimin Mjedisorë pranë Policisë së Kosovës, në të cilën thuhet se inspektimi i tyre nuk vuri në dukje ndonjë degradim të mjedisit përreth zonës ku ndodhen tre hidrocentralet e operuara nga Kelkos.⁴⁷ Sidoqoftë dhe pavarisht gjetjeve të Policisë së Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Mjedisit që të pezullojë përkohësisht lejen e veprimtarisë së hidrocentraleve, duke cituar mungesën e transparencës, parregullsi në procedurat e licensimit, si dhe “ndikimin e qartë në degradimin e mjedisit”.⁴⁸

⁴¹Balkan Insight, “Ideale të Gjelbërta, Energji e Ndotur: Fushata e mbështetur nga BE-ja për energji të rinovueshme që morri rrugën e gabuar,” 15 dhjetor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/12/15/green-ideals-dirty-energy-the-eu-backed-renewables-drive-that-went-wrong/>

⁴²Kosova renditet e 101-ta nga 180 vende në Indeksin e Transparency International për Përceptimin e Korrupsionit.

⁴³ Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), “Hidrocentralet në parqet kombëtare: Një rrezik për Biodiversitetin,” 25 shkurt 2019. Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), “Reporti mbi Gjendjen e Natyrës 2015-2017”, faqe 68, available at: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_natyra_eng.pdf.

⁴⁴ Fondacioni i Gjelbër i Ballkanit dhe INDEP, “Hidrocentralet në Kosovë – problemet dhe potenciali real”, mars 2019, faqe 18. https://www.balkangreenfoundation.org/uploads/files/2020/July/13/Hydropower_Plants_in_Kosovo_the_problems_and_their_real_potential1594649058.pdf

⁴⁵ Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), “Hidrocentralet në parqet kombëtare: Një rrezik për Biodiversitetin,” 25 shkurt 2019.

⁴⁶ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 7.

⁴⁷ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 8.

⁴⁸ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjen në informata, 03 shkurt 2021. Paragrafi 9.

Rritja e pakontrolluar e numrit të hidrocentraleve nuk përbën shqetësim vetëm për aktivistet e mjedisit. Gjatë dy viteve të fundit, komunitetet vendore janë bërë gjithnjë e më mosbesues ndaj procesit të licensimit dhe rezistuese ndaj planeve për ndërtimin e hidrocentraleve të reja në zonat ku banojnë. Shqiptarët dhe serbët që jetojnë në fshatra të ndara pas konfliktit të viteve 1989-1990 në Kosovë, kanë protestuar së bashku përgjatë 2019-ës dhe 2020-ës kundër ndërtimit të hidrocentraleve të reja në Shtrëpcë⁴⁹ (i cili menaxhohet nga një kompani tjetër) ndërsa protestat e dhjetra mijëra qytetarëve kanë ndaluar ndërtimin e projekteve të ngjashme në qytetin e Pejës. “Hidrocentralet janë kthyer në një pikë tubimi për komunitetet që bashkohen për të shpëtuar lumin e tyre,” u shpreh Fitore Pacolli për Amnesty International.⁵⁰ “A tyre nuk i interesonte çfarë kombësie kishin; u interesonte uji i tyre”.⁵¹

Në prillin e vitit 2021, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Liburn Aliu, raportoi që gjatë vizitave të panjoftuara të disa hidrocentrale (që nuk operohen nga Kelkos Energy) në Malin e Sharrit, ekipi i tij i punës u përballën me nivele shqetësuese të ulëta uji në lumenjtë e ndikuar, të cilat po rridhnin në mënyrën e zakonshme gjatë ditës së vizitës, gjë që sugjeron se zyrtarët e komunës dhe kompanitë energjitike mund të jenë duke u përpjekur që të fshehin ndikimin real të veprimtarisë së tyre.⁵²

Sipas Përspektivës së Sigurisë së Bankës Botërore për Kosovën, vendi ka pamjaftueshmëri burimesh ujore dhe po përjeton një ndër nivelët më të ulëta në rajon.⁵³ Burimet e saj të kufizuara ujore, ku vetëm njëri prej lumenjëve të saj rrjedhë jashtë territorit, cilësohen të mbipërdorur dhe të cenueshëm si pasojë e keqmenaxhimit institucional, rritjes së popullsisë dhe ekonomisë, nevojave për vaditje, dhe mes të tjerash edhe kërkesave të shtuara për tu përdorur në sektorin e energjisë.⁵⁴

Me mbi 60% të popullsisë së Kosovës që jetojnë në zonat rurale dhe me një prej niveleve më të larta të varfërisë në Evropë (25% e qytetarëve jetojnë nën nivelin e varfërisë kombëtare ose në varfëri ekstreme),⁵⁵ agrikultura e cila mbështetet së tepërmi në burime ujore, ofron të vetmin burim të sigurtë jetese për një përqindje të lartë të popullsisë së Kosovës. Përhapja e pakontrolluar e hidrocentraleve përbën një kërcënim të shtuar për jetën e tyre.

NJË MODEL KËRCENIMI GJYQËSOR

Padia e Kelkos Energy kundër znj. Loshaj nuk është rasti i vetëm në të cilin kompania përpiqet të heshtë aktivistet e mjedisit. Në një padi të ngjashme në 2020-ën, Kelkos Energy paditi z. Gacaferi, një aktivist mjedisor nga Deçani, lidhur me një postim të tij në rrjetet sociale ku thuhej se hidrocentralet e Kelkos Energy kanë përdorur 100% të ujit të nxjerrë me metodën sifon në tubat e saj dhe për rrjedhojë nuk ka lënë as të paktën 30% të ujit të derdhet në shtratin e lumit.⁵⁶ Kelkos Energy kërkoi dëmshpërblim prej EUR 10,000 nga z. Gacaferi për dëmtim imazhi.

Kelkos Energy ka përdorur procedurat ligjore ose ka kërcënuar me padi për të dekurajuar çdo diskutim rreth veprimtarisë së saj. Në qershor të vitit 2020, 60 organizata joqeveritare dhe aktivistë nga Kosova (përfshirë znj. Loshaj) i dërguan një letër Ministrisë së Jashtme të Austrisë, Ambasadës Austriake dhe Zyrës së Delegacionit të BE-së në Kosovë, me anë të së cilës ata ngritën shqetësimet e tyre lidhur me degradimin mjedisor të shkaktuar nga hidrocentralet dhe përfshirjen e mundshme e të parregullt të diplomatëve austriakë të cilët, siç u shprehen ata, mund të kenë vënë nën presion të paduhur autoritetet vendore gjatë procesit të licensimit.⁵⁷ Pak përpara aksionit të OJQ-ve, avokatët e Kelkos Energy u kanë shkruar të gjithë OJQ-ve të përfshira dhe znj. Loshaj, për t'i njoftuar se kanë ngritur një padi për shpifje kundër znj. Loshaj

⁴⁹ Reuters, “Fshati i ndarë malor në Kosovë bashkohet për të kundërshtuar hidrocentralin,” 11 tetor 2019, <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-environment-protest-idUSKBN1WQ21H>, N1, “Serbët dhe Shqiptarët protesojnë sëbashku kundër hidrocentralit të vogël në Kosovë,” 27 shkurt, 2020, <https://rs.n1info.com/english/news/a573059-serbs-and-albanians-join-in-protest-against-small-hydropower-plants-in-kosovo/>

⁵⁰ Intervistë e Amnesty International me deputetën Fitore Pacolli, 22 qershor 2021.

⁵¹ Intervistë e Amnesty International me deputetën Fitore Pacolli, 22 qershor 2021.

⁵² Kallxo, “Ministri Aliu paralajmëron shqyrtim të lejeve të hidrocentraleve,” 24 prill 2021, <https://kallxo.com/lajm/ministri-aliu-paralajmëron-shqyrtim-te-lejeve-te-hidrocentraleve/>

⁵³ Grupi i Bankës Botërore 2018, “Përspektiva e Sigurisë së Ujit në Kosovë,” faqe.11.

⁵⁴ Grupi i Bankës Botërore 2018, “Përspektiva e Sigurisë së Ujit në Kosovë,” faqe.11.

⁵⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Grupi i Bankës Botërore, “Konsumimi i varfërisë në Republikën e Kosovës,” maj 2019, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/210201560762490515/pdf/Consumption-Poverty-in-the-Republic-of-Kosovo.pdf>

⁵⁶ Gjykata Themelore Pejës, Padi për dëmshpërblim të cenimit të imazhit me shifje kundër z. Mr Adriatik Gacaferi, 31 janar 2020.

⁵⁷ Prishtina Insight, “60 organizata denojnë rolin e Ambasadës Austriake në veprimtarinë «e paligjshme» të hidrocentralit,” 30 qershor 2020, <https://prishtinainsight.com/60-organizations-condemn-austrian-embassys-role-in-illegal-hydropower-operation/>

dhe kanë kërcënuar se do marrin hapa të tjerë ligjor kundër saj nëse ajo nuk e tërheqë letren brënda tetë orësh dhe kërkon falje me shkrim se “i ka shkaktuar dëme të pariparueshme të reputacionit” kompanisë.⁵⁸ Sipas të njëjtës qasje, Kelkos Energy ka kërcënuar se do të marrë “hapa ligjor kundër çdo individ që shpërndan informacion me përmbajtje të rreme - me qëllim të dëmtimit të reputacionit të saj si ndërmarrje”.⁵⁹ Në një komunikim me Amnesty International, Kelkos Energy ka mohuar fuqishëm çfarëdolloj ndërhyrje të pavend nga Ambasada e Austrisë në emër të kompanisë, dhe shtoi që Ambasadori ka shoqëruar Kelkos Energy te një takim të rastit “me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje pragmatike për... deficite administrative,” duke iu referuar vonesave që lidhen me lëshimin e lejeve të vonuara.⁶⁰

Ndërsa znj. Loshaj dhe organizatat e tjera nuk përmbushën kërkesat e Kelkos Energy, asnjë padi nuk u ngrit kundër organizatave në atë kohë.⁶¹ Megjithatë, edhe një kërcënim i thjeshtë me padi mund të mjaftojë që të heshten zërat kritikë, gjë që ka një efekt negativ kundrejt mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile të cilat punojnë për të ekspozuar personat në pushtet. “Unë jetoj jashtë vendit dhe jam në gjendje të jem e kritike, por aktivistët e tjerë në Kosovë kanë shumë më shumë për të humbur – punën dhe jetesën. Këto padi janë frikësuese sepse qëllimi i tyre është i tillë,” u shpreh znj. Loshaj për Amnesty International.

Kelkos Energy argumenton se fushata publike e znj. Loshaj dhe z. Gacaferi kundër hidrocentraleve i kanë shkaktuar vonesa në procedurat e licensimit dhe dëme të mëdha ekonomike bashkë me dëmtimin e reputacionit të kompanisë. Kelkos Energy pretendon se paditë janë “mjet mbrojtës i dorës së fundit për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të kompanisë tonë nga deklaratat e pavërteta [të aktivistëve]”.⁶² Megjithatë, Amnesty International cilëson se raportet zyrtare të lëshuara nga institucionet publike si ZRRE, hedhin dyshime të mjaftueshme mbi procedurat e licensimit që i japin hapësirë znj. Loshaj dhe z. Gacaferi ta vëjnë në pikëpyetje procesin. Këto raporte përmbajnë deklarata që krijojnë bazën për të dy aktivistët e mjedisit të angazhohen publikisht dhe të shprehin shqetësimet e tyre. Znj. Loshaj dhe z. Gacaferi kanë dorëzuar shumë kërkesa për qasje në dokumente që lidhen me hidrocentralet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por kanë marrë pak përgjigje, duke i shtyrë ata që të kërkojnë transparencë më të madhe nga autoritetet dhe kompaniet energjitike si dhe pjesëmarrje më kuptimplote të komuniteteve të prekura.⁶³

Është e pamohueshme që angazhimi publik dhe aktivizimi i palodhur i znj. Loshaj dhe z. Gacaferi ka rezultuar direkt në ose ka kontribuar në përpjekjet e fundit të institucioneve publike që të hetojnë parregullsitë e mundshme dhe të sigurojnë transparencë më të madhe të procedurave. Disa prej këtyre proceseve kanë konfirmuar shqetësimet dhe dyshimet e aktivistëve. Formimi i hetimit parlamentar në shtator të 2020-ës, hetimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në 2019/2020-ën dhe vendimi i Ministrisë së Mjedisit në prill 2021 për të rishikuar procedurat e licensimit për hidrocentralet flet për fuqinë e aktivizimit qytetar dhe rëndësinë e mbikqyrjes publike të proceseve qeveritare që ndikojnë drejtëpërsëdrejti mbi jetën e qytetarëve. Përpjekjet e znj. Loshaj janë njohur në mars kur ajo u dekorua nga Presidentja për punën e saj në mbrojtjen e lumenjëve të Kosovës dhe ku u lavdërua për “kurajon e saj për të sfiduar padrejtësinë”.⁶⁴

PADITË SLAPP HESHTIN ZËRAT KRITIK DHE MINOJNË LIRINË E SHPREHJES

⁵⁸ Email nga avokati i Kelkos Arianit Koci dërguar Shpresa Loshaj dhe shumë OJQ-ve, 26 qershor 2020. I disponueshem për Amnesty International.

⁵⁹ Email nga avokati i Kelkos Arianit Koci dërguar Shpresa Loshaj dhe shumë OJQ-ve, 26 qershor 2020. I disponueshem për Amnesty International.

⁶⁰ Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 13.

⁶¹ Në letrën e adresuar znj. Loshaj, avokatët e Kelkos Energy e informuan atë se kishin paditur në gjykatë, dhe nëse ajo do ta dërgonte letrën, ata do t'i shtonin pretendimet në padi për të përfshirë edhe letrën. Kjo është padia që znj. Loshaj e ka marrë më 16 shkurt 2021 por është depozituar më 1 qershor 2020. Megjithatë, padia nuk përfshinte pretendimet e ngritura në letër..

⁶² Reagimi me shkrim i Kelkos Energy/Kelag International në përgjigje të kërkesës për informacion nga Amnesty International, 21 qershor 2021, faqe 1.

⁶³ Intervistë me znj. Loshaj dhe z. Gacaferi, 16 dhe 21 qershor 2021.

⁶⁴ Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, «Presidentja në Detyrë Osmani akordon urdhrin “Shotë Galica”, mars22, <https://president-ksgov.net/en/news/acting-president-osmani-awards-the-shote-galica-order-to-8-women>

“Ne, populli i Kosovës, kemi kaluar luftën për të fituar të drejtën për të jetuar dhe folur të lirë. Unë nuk mund ta pranoj që kemi luftuar dhe sakrifikuar kaq shumë për këtë vend dhe të drejtat tona vetëm që të na thonë se ne nuk mund të themi asgjë lidhur me shkatërrimin e tokës dhe ujit tonë. Por unë nuk do të ndalëm. Kjo është liria – të kesh mundësinë të ngresh zërin kur sheh padrejtësi. Ne jemi brezi i parë i Kosovarëve që jetojnë në demokraci dhe ja kemi borxh atyre që dhanë jetën e tyre për të na e mundësuar ne që të jetojmë në demokraci, Shpresa Loshaj, aktiviste e mjedisit.

Paditë SLAPP janë padi të ngritura, ose kërcënime për padi, me qëllim heshtjen ose frikësimin e pjesëmarrjes publike. Paditë SLAPP shpesh shënjestrojnë gazetarët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizatat e shoqërisë civile, aktivistët dhe akademikët me qëllim heshtjen e tyre ose frenimin e zërave të tjerë kritikë. Paditë SLAPP jo domosdoshmërisht synojnë që të mbrojnë nderin apo reputacionin e një individi apo një koorporate, por përkundrazi synojnë të trembin, lodhin dhe shterojnë burimet financiare dhe psikologjike të palës së shënjestruar prej tyre.⁶⁵

Kostot për t’iu kundërvënë këtyre veprimeve ligjore mund të ushtrojnë presion ekstrem financiar dhe presione të tjera mbi aktivistët e të drejtave të njeriut duke i detyruar që të riorientojnë fondet e tyre të kufizuara dhe burimet e nxjerra nga puna për tu mbrojtur nga padia. Procesi gjyqësor është shpesh i suksesshëm në tërheqjen e vëmendjes nga çështjet e mjedisit dhe të drejtat e njeriut drejt çështjes së padisë ligjore. Sikurse është shprehur Raportuesi i Veçantë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat për tubim paqësor dhe të shoqatave, SLAPP paditë devijojnë diskutimet mbi përgjegjësinë shoqërore të korporatave që, "duke u maskuar si padi të zakonshme civile, i shndërrojnë çështjet me interes publik në kontekstet teknike të së drejtës private".⁶⁶ Në Evropë, paditë SLAPP janë shpesh duke marrë formën e akuzave për shpifje me kërkesa të pabazuara ose joproporcionale për dëmshpërblim.⁶⁷

Përdorimi i padive SLAPP është identifikuar nga disa mekanizma të të drejtave të njeriut si një shkelje e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, i cili përbën sfida në rritje ndaj të drejtës për liri të shprehjes dhe aftësisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut për të operuar në një mjedis të sigurtë dhe fuqizues.⁶⁸ Paditë SLAPP minojnë të drejtën e lirisë së shprehjes të atyre që flasin hapur në mbështetje të interesave publike dhe si rrjedhojë e efektit frenues krijon një mjedis gjithnjë e më armiqësor për gazetarët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile.⁶⁹ Kur individët që mund të shpërndajnë informacione të rëndësishme me interes publik heshten, debati publik shkurajohet dhe e cënon të drejtën e qytetarëve qasje në informata dhe për pjesëmarrje publike.

Neni 19 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) garanton të drejtën për të dhënë opinione pa ndërhyrje dhe të drejtën për të shprehur i lirë idetë dhe opinionet e të gjitha formave.⁷⁰ E drejta e lirisë së shprehjes, e

⁶⁵ Petra Bard, Judit Bayer, Ngo Chun Luk dhe Lina Vosyliute, Kërkesë Ad-Hoc SLAPP në kontekstin e BE-së, BE-Qytetar: Rrjeti Akademik për të Drejtat Qytetare Evropiane, maj 2020, https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/ad-hoc-literature-review-analysis-key-elements-slapp_en.pdf

⁶⁶ Raportuesi i Veçantë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e organizimit paqësor dhe asociimit, shenim informative mbi SLAPP-et dhe të drejtat e FOAA, e qasur me 12 maj 2021.

⁶⁷ Universiti i Amsterdimit & Greenpeace International, "Kërkim mbi SLAPP – përfundimet paraprake," https://www.umweltinstitut.org/fileadmin/Mediapool/Downloads/01_Themen/05_Landwirtschaft/Pestizide/Suedtirol/University_of_Amsterdam_GPI_Research_SLAPPs_.pdf

⁶⁸ Raportuesi i Veçantë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e organizimit paqësor dhe asociimit, shenim informative mbi SLAPP-et dhe të drejtat e FOAA, e qasur me 12 maj 2021.

⁶⁹ Petra Bard, Judit Bayer, Ngo Chun Luk dhe Lina Vosyliute, Kërkesë Ad-Hoc SLAPP në kontekstin e BE-së, BE-Qytetar: Rrjeti Akademik për të Drejtat Qytetare Evropiane, maj 2020, https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/ad-hoc-literature-review-analysis-key-elements-slapp_en.pdf

⁷⁰ Kosova nuk është vend anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës dhe si e tillë nuk mund të bëhet pjesë formale e marrëveshjeve dhe mekanizmave të drejtave ndërkombëtare të njeriut, megjithatë, Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se tetë instrumenta të të drejtave të njeriut të OKB-së janë të zbatueshme në Kosovë, dhe mbizotërojnë në rast të mospërputhjes me ligjet vendore, përfshi dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Marrëveshja Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit me bazë Racën, Marrëveshja Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Marrëveshja mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Marrëveshja mbi Torturën

cila përfshin të drejtën për të kërkuar, marrë dhe dhënë informata dhe ide pa ndërhyrje, garantohet po ashtu me Nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Deklarata e OKB-së për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut pohon që të gjitha shtetet duhet të mbrojnë të drejtën për të kërkuar, siguruar, marrë dhe për të mbajtur informacion në lidhje me të drejtat e njeriut dhe për ta ndarë këtë informacion me të tjerët, si dhe për të siguruar që mbrojtësit e të drejtave të njeriut ta ushtrjnë këtë të drejtë pa frikën se do të përballeshin me hakmarrje.

Shtetet kanë detyrimin negativ për të respektuar ushtrimin e këtyre të drejtave dhe detyrimin pozitiv për të mbrojtur ushtrimin e këtyre të drejtave, në këtë rast për të parandaluar pengesat e panevojshme të palëve të treta. Komisioni i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (CESCR)⁷¹ ka përcaktuar detyrimin ndaj shteteve për të mbrojtur individët nga ndërhyrja e palëve të treta në rrethanat e aktivitetit të biznesit. Veçanërisht, CESCR ka theksuar që “prezantimi i aksioneve të korporatave për të shkurajuar individët apo grupet nga ushtrimi i mjeteve juridike, si për shembull duke pretenduar dëmtimin e reputacionit të korporatës, duhet të mos abuzohet për të krijuar një ndikim frenues të këtyre mjeteve ligjore”.⁷²

Për më tepër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) vazhdimisht ka njohur rolin e rëndësishëm që luan shoqëria civile për t'u kërkuar llogari autoriteteve dhe biznesit dhe për t'i nxitur shtetet që të krijojnë një hapësirë të sigurtë dhe fuqizuese për mbrojtësit e të drejtave të njeriut për t'u përfshirë në debate publike dhe për t'u mundësuar të gjithë qytetarëve të shprehin idetë dhe opinionet e tyre pa frikë.⁷³ Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtën për lirinë e shprehjes nga çfarëdo shkelje, përfshirë edhe nga qytetar privat por edhe njësi.⁷⁴ GjEDNJ gjithashtu ka vendosur që dëmet e larta të paarsyeshme për shpifje mund të kenë një efekt frenues në lirinë e shprehjes.⁷⁵

Përveç detyrimeve ndaj shteteve, Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (Parimet Udhëzuese të OKB-së) të aprovuara unanimisht, shprehin qartazi që ndërmarrjet duhet të respektojnë të gjitha të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht kudo që operojnë.⁷⁶ Kjo përgjegjësi e korporatave është e ndarë nga detyrimet e vendosura nga ligji vendor. Sikurse thuhet në Parimet Udhëzuese të OKB-së, “[ajo] ekziston pavarësisht nga mundësitë e një shteti ose vullneti për të përmbushur detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut. Dhe ekziston mbi dhe përtej pajtueshmërisë me ligjet kombëtare dhe rregullat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”.⁷⁷

Në këtë kontekst, sipërmarrja e biznesit duhet të identifikojë, të parandalojë, të zgjidhë dhe të japë llogari si do të adresohet ndikimi aktual dhe ai potencial mbi të drejtat e njeriut.⁷⁸ Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur sipërmarrja e biznesit përdorin SLAPP për të heshtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e tyre të njohura ndërkombëtarisht për lirinë e shprehjes, asociimit dhe tubimit paqësor.

Paditë SLAPP mund të identifikohen nëpërmjet disa elementeve kyç: (i) ato janë shpesh të motivuara politikisht dhe të pabazuara; (ii) ato pretendojnë shpërbllime monetare ose një vendim gjyqësor; (iii) ato janë shpesh të ngritura nga zyrtarë në pushtet ose nga njësi biznesi kundër një pale joqeveritare ose një grupi; (iv) mbi një angazhim për çështje me interes

dhe Format e Tjera të Trajtimit Mizor, Cnjerzor, Degradues dhe Denimit. Gjithashtu, Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në mënyrë të vazhdueshme me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

⁷¹Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR) nuk është i përfshirë në Kushtetutën e Kosovës mes instrumentave ndërkombëtare të drejtave të njeriut që janë të zbatueshme në vend. Megjithatë, ICESCR është e aplikueshme si rezultat i Pjesës 1.1. të Rregullorës së UNMIK-ut no. 199/24 Mbi Ligjin e Zbatuar në Kosovë e lexuar në lidhje me nenin 210 dhe kushtetutën e vitit 1974 të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (shih HRI/CORE/UNK/1, paragrafi 121). Të drejtat ICESCR janë të ligjëruara dhe të zbatueshme në gjykatat dhe tribunalet e Kosovës, si instrumenta madhore të të drejtave të njeriut të aplikueshme në territorin e provincës me virtyt të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Për më tepër, neni 9 i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, përsërit përkushtimin e Kosovës për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare, përfshi ato të përfunduara në emër të Kosovës nga UNMIK-u”.

⁷²Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, Koment i përgjithshëm no. 24 (2017) mbi Detyrimet shtetërore që rrjedhin nga Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në kontekstin e veprimtarisë së biznesit,” E/C.12/GC/24, 10 gusht 2017

⁷³ Çështja Dink kundër Turqisë, 14 dhjetor 2010

⁷⁴ Gazeta Independent e pavarur kundër Irlandës (no. 28199/15), 15 qershor 2017, [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-174419%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-174419%22]})

⁷⁵ Gazeta Independent e pavarur kundër Irlandës (no. 28199/15), 15 qershor 2017, [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-174419%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-174419%22]})

⁷⁶ Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (Parimet Udhëzuese të OKB-së), Parimet 11 dhe 12

⁷⁷ Parimet Udhëzuese të OKB-së, Parimi 11 (Komentues).

⁷⁸ Parimet Udhëzuese të OKB-së, Parimi 15 (b).

publik.⁷⁹ Paditë e Kelkos Energy kundër znj. Loshaj dhe z. Gacaferi përmbajnë të gjitha këto elemente dhe shfaqën të jenë asgjë më shumë sesa një taktikë ligjore për të njollosur reputacionin e tyre dhe vlefshmërinë e gjetjeve të tyre me anë të praktikave frikësuese për t'i detyruar të ndalojnë debatin publik mbi procesin e licensimit dhe ndikimin mjedisor të veprimtarisë së Kelkos Energy në Kosovë. Kështu, ato përbëjnë një ndërhyrje të panevojshme dhe joproporcionale në të drejtat e tyre për lirinë e shprehjes dhe qasjes në informata.

PËRFUNDIM

Paditë për shpifje të Kelkos Energy kundër aktivistëve mjedisorë në Kosovë pasqyron tendencën në rritje të korporatave të fuqishme për zyrtarëve publikë në Evropë që keqpërdorin sistemin e drejtësisë për të shënjestruar dhe për të trembur mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për tu mbrojtur nga vëzhgimi i afërt publik. Pretendimet e pabaza dhe jo proporcionale për dëme po përdorën si pjesë e një strategjie të gjerë për të trembur dhe heshtur aktivistët e të drejtave të njeriut dhe mjedisit dhe për të kufizuar pjesëmarrjen publike, në vend që të sigurojë një zgjidhje për dëmin e pretenduar të imazhit.

Në të gjithë Kosovën, gazetarët kanë qënë shpesh në shënjestrën e padive për shpifje nga zyrtarët publikë dhe korporatat gjatë viteve të fundit. Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon-Taubadel ka kritikuar padinë e Kelkos Energy kundër znj. Loshaj dhe z. Gacaferi duke argumentuar se rritja e numrit të padive për shpifje në Kosovë përbën kërcenim të konsiderueshëm ndaj debatit public dhe lirisë së shprehjes.⁸⁰

Kelkos Energy duhet të tërheqë pa u vonuar padinë për shpifje kundër znj. Shpresa Loshaj dhe z. Adriatik Gacaferit në Kosovë për vepruar sipas përgjegjësisë së Kelkos Energy për të respektuar të drejtat e njeriut dhe për të lejuar debatin e lirë publik mbi shqetësimet mjedisore të komuniteteve të prekura nga veprimtaria e hidrocentraleve të tyre.

Për më tepër, autoritetet e Kosovës duhet të veprojnë për të siguruar që të gjithë qytetarët të ushtrojnë lirinë e shprehjes, qasjen në informata dhe pjesëmarrjen publike pa patur frikë nga hakmarrja, duke përfshirë paditë SLAPP ose formave të tjera të keqpërdorimit të sistemit të drejtësisë. Amnesty International e mirëpret vendimin e fundit të Ministrisë së Mjedisit për të rishikuar procedurat për të lëshuar licencat për veprimtari kompanive energjitike që menaxhojnë hidrocentrale.

Autoritetet, përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe komunat përkatëse, duhet të ndër marrin hapat e duhur për t'u siguruar që të gjitha komunitetet e ndikuara të kenë qasje në informata dhe dokumente që lidhen me konsultimet e projekteve të mëdha për shfrytëzimin e burimeve natyrore në zonat ku operojnë dhe mundësitë për pjesëmarrje efektive në procesin e vendimmarrjes. Autoritetet duhet të miratojnë ligje dhe politika në përputhje me detyrimet e tyre për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në kontekstin e aktiviteteve të korporatave nëpërmjet rregullimit adekuat, mbikqyrjes, hetimit, gjykimit dhe dënimit.

Paditë SLAPP shihen gjithnjë e më shumë si një kërcenim serioz kundër të drejtave për lirinë e shprehjes dhe qasjes në informata në Evropë. Amnesty International e përshëndet përkushtimin e Zëvendës-Presidentës së Komisionit Evropian, Věra Jourová për të nisur hartimin e një legjislacioni brenda BE-së për t'u kundërvënë padive SLAPP. Një direktivë kundër padive SLAPP duhet të krijojë një standard minimal për t'u mbrojtur kundër proceseve të tilla gjyqësore, dhe duhet të sigurojë që gjykatat të mund t'i identifikojnë në mënyrë të përsheptuar dhe t'i refuzojnë paditë e tilla në procedura të hershme, të urdhërojnë sanksione ndaj procedurave ligjore shqetësuese të cilat abuzojnë me ligjin dhe t'u japë mundësi gjykatave të ofrojnë masa procedurale mbrojtëse, përfshirë edhe me asistencë ligjore falas për viktimat e padive SLAPP.⁸¹ Këto masa duhet të kenë si qëllim sigurimin e barazisë në mjete mes palëve të përfshira që përfshijnë

⁷⁹ Bard, Petra, Bayer, Judit, Chun Luk, Ngo & Volsyliute, Lina, "SLAPP në kontekstin e BE-së," 29 maj 2020 bazuar në përcaktimin fillestar të SLAPP ose padive SLAPP nga Pring & Canan, SLAPP-et: Të Paditesh se Ngre Zërin, 1996, fq. 221. Shih gjithashtu Ravo, L., Borg-Barhet, J. & Kramer, X, "Mbrotja e mbikqyrësve publik në BE: Një Propozim për ligjin kundër padive SLAPP," 1 dhjetor 2020, https://dq4n3btxmr8c9.cloudfront.net/files/zkecf9/anti-SLAPP_model_directive_paper_final.pdf

⁸⁰ Faqja e internetit të Viola von Cramon, <https://violavoncramon.eu/themen/inhalt/increasing-slapp-lawsuits-in-kosovo/> and Twitter Account Post, 19 February 2021, <https://twitter.com/ViolavonCramon/status/1362848511851692033?s=20>

⁸¹ Shih, për shëmbull, Euroactive, "Nuk duam të na heshtin me padi," nga grupi i organizatave ndërkombtare dhe OJQ-ve, 16 nëntor 2020, <https://www.euractiv.com/section/all/opinion/we-dont-want-to-be-sued-into-silence/> dhe Ravo, L., Borg-Barhet, J. & Kramer, X., "Të mbrohen monitoruesit në BE: Një propozim për një ligj kundër padive strategjike," 1 dhjetor 2020, https://dq4n3btxmr8c9.cloudfront.net/files/zkecf9/anti-SLAPP_model_directive_paper_final.pdf

pjesëmarrjen publike dhe kanë lidhje me interesin publik, dhe së fundi ofron një zgjidhje efektive si për palën paditëse ashtu edhe për palën e paditur.

Megjithëse Kosova nuk është vend anëtar i Bashkimit Evropian, legjislacioni gjithëpërfshirës i BE-së do të ofronte një standard të rëndësishëm për vendet anëtare dhe ato aspiruese. Pa veprime të menjëhershme dhe ndërgjegjësime më të madh ndaj kërcënimeve që rrjedhin nga paditë shqetësuese, paditë SLAPP mund të kenë një ndikim shkatërrues ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile.

/FUND